



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:297114  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05637064

KPPP.nr.1570/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kulinare Sh.P.K., me adresë në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, Km 10, te Pro Crediti në Prishtinë, me NRB: 810115718, kundër debitorit TechnoBurimi, D.D. Sh.A., me adresë Kullat e Malokve, pn. Shupkovic, në Mitrovicë, me NRB: 70549778, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.547/21 të datës 08.12.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit TechnoBurimi, D.D. Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.547/21 të datës 08.12.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.547/21 të datës 08.12.2021, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.3715/21 të datës 25.05.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 13,838.66 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës, e gjer në pagesën definitive të borxhit

kryesor dhe kamatës si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka theksuar se fatura 3715/2021 ka edhe pagesa tjera të bashkangjitura. I ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit ndërsa të anulohet propozimi për përbarim nga Përbaruesi Privat, si dhe të prishen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimi i debitorit se fatura 3715/2021 ka edhe pagesa tjera të bashkangjitura, është totalisht i pabazuar, për faktin se debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë dhe asnjë dokument me të cilin do ta dëshmonte një gjë të tillë. Më tej ka shtuar se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm i cili përmban të gjitha elementet e nevojshme të parapara në ligjin për procedurën përbarimore, dhe si i tillë nuk përbën asnjë të metë juridike, dhe për këtë arsye i ka të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pathemeltë prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat, si dhe të detyrohet debitori që ta paguaj garancionin, minimalisht në shumën e borxhit kryesor në rast të ushtrimit të ankesës, në të kundërtën ankesa nuk do të shqyrtohet fare.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.3715/21 të datës 25.05.2021 në shumën prej 15,598.60 Euro, dhe deri në paraqitjen e propozimit për përmbartim debitori ka arritur që ta paguajë vetëm një pjesë të borxhit, ndërsa borxhi i mbetur nga kjo faturë është në shumën prej 13,838.66 Euro, fakt ky i cili vërtetohet në propozimin për përmbartim nga vet kreditori.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur përmban të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1570/23, me datë 22.04.2024

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.